



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

## BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 11 11 - 17 Mars 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

### NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 11

	JAVA 10
DIARRE PA GJAK	1.284
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	8.450
INF. RESP. TE POSHTËME	4.491
RASH ME TEMPERATURË	23
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	433
% e Njësive Raportuese	98% (433/441)

### **Rash me temperaturë**

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Fier – 3 raste

Gjirokastrë – 2 raste

Kurbin – 1 rast


Pogradec – 1 rast

Tiranë – 16 raste


---

### Infeksione respiratore

*Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve*




*Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave*




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën 11 krahasuar me javën paraardhëse, java 10.

### Diarre pa gjak

*Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve*




*Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave*




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqitet ritje në javën 11 krahasuar me javën paraardhëse, java 10.

**Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




**Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 01 – 11 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.**




Në javën 11 të vitit 2024 vërehet prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


**Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)**



**Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 10 dhe 11 / 2024. Incidenca (raste/10.000)**




**Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 01 - 11 të viteve 2023 dhe 2024.  
Numri i rasteve.**



Në javën 11 të vitit 2024 vërehet prirje në ritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

**Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 10 dhe 11 / 2024.  
Incidenca (raste/10.000)**



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

## Ngjarje ndërkombëtare

### 1. Fruthi – Monitorimi i shpërthimeve evropiane

- Në dhjetor 2023, 124 raste të fruthit u raportuan nga nëntë vende në Sistemin Evropian të Survejancës (TESSy). Midis janarit dhe dhjetorit 2023, 2 361 raste të fruthit u raportuan në TESSy nga 23 vende.
- Nëpërmjet inteligjencës epidemike, ECDC ka identifikuar 3 507 raste të reja të fruthit në 18 vende të BE/ZEE që nga përditësimi i fundit mujor, duke përfshirë raporte mbi shpërthimet e vazhdueshme midis të tjerave në Austri, Qipro, Francë, Holandë, Portugali dhe Rumani.
- Nëntë vdekje nga fruthi janë raportuar në Rumani (8) dhe Irlandë (1); në Rumani katër vdekje ishin te fëmijët nën moshën një vjeçare dhe dy te të rriturit me sëmundje shoqeruese. Një i rritur vdiq në Irlandë.
- Në përgjithësi, transmetimi i fruthit aktualisht mbetet i ulët në BE/ZEE.

### 2. Kolera – Komore – 2024 – Monitorimi javor

- Që nga përditësimi i fundit i disponueshëm më 4 mars dhe më 13 mars 2024, 87 raste të reja të kolerës dhe gjashtë vdekje janë raportuar në Komore.
- Që nga fillimi i shpërthimit dhe deri më 13 mars 2024, janë raportuar 227 raste të konfirmuara të kolerës dhe 12 vdekje. Rastet u raportuan në Grande Comore, Moheli dhe Anjouan.
- Duke pasur parasysh lëvizjen intensive të njerëzve midis ishujve Komoros dhe Mayotte dhe kushteve të favorshme lokale në ishull, ECDC vlerëson rrezikun e kolerës për popullsinë që jeton në Mayotte si të moderuar.

## Ngjarje kombëtare

### 3. Situata epidemiologjike e fruthit

Për periudhën Janar – 18 Mars 2024 janë testuar 158 raste të dyshuar nga të cilët janë konfirmuar 35 (22.5%) raste me Fruth.

- Nga keto 32 raste janë konfirmuar në laboratorin kombëtar të referencës të virologjisë në ISHP dhe 3 raste janë të konfirmuar sipas perkufizimit të rastit mbeshtetur në shenjat klinike dhe epidemiologjike. Incidenca e sëmundjes në vend është 1.3 raste/100 000 banorë.
- Rastet i perkasin moshes nga 0-38 vjeç (mediana 5 vjeç).
- Numri më i lartë i perkët grupmoshes 5-9 vjeç me 34.3% të totalit të rasteve të konfirmuar.
- Incidenca më e lartë është në grupmoshën 2-4 vjeç me 13.4 raste/100 000 banorë.
- Nga 35 rastet e konfirmuar 20 (57%) prej tyre janë shtruar në spital dhe 15 raste (43%) kanë qëndruar në kushte shtëpie.
- Numri më i lartë i rasteve i perkët Tiranës 22 raste ose 62.9% e totalit.
- Incidenca më e lartë e ka Durresin me 4.7 raste/100 000 banorë.